

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7910
E shtunë, 19 tetor 2024
Çmimi 0.50

Raundi i ri i dialogut Kosovë - Serbi, javën e ardhshme

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

ÇFARË PO NDODH ME USHQIMIN PËR USHTARËT?

FAQE 4-5



Çështja e furnizimit me ushqim për Forcën e Sigurisë së Kosovës është shndërruar në një temë që e ka përplasur së fundi opozitën me partinë në pushtet. Përderisa opozitarët thonë se FSK-ja ka

mbetur pa bukë, Ministria e Mbrojtjes argumenton se u përmbahet standardeve të NATO-s sa i përket ushqimit të ushtarëve. Për t'i shmangur pasiguritë në të ardhmen, për

shkak të problemeve që mund të shfaqen me kompanitë furnizuese, qeveria tani dëshiron që FSK-ja të ketë vetëqëndrueshmëri sa i përket ushqimit


ÇËSHTJA E KOSOVËS DHE POLITIKA E JASHTME, FAKTORË PËR VOTËN E SHOIPTARO-AMERIKANËVE NË MIÇIGAN

F. 3



FUSHA "BIZNES, ADMINISTRATË DHE LIGJ" VAZHDON TË JETË MË E PËLQYERA NGA STUDENTËT E RINJ

F. 7



RENOVA
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mobi: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com


Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



HARADINAJ UDHËTON NË SHBA, PARALAJMËRON TAKIME ME KONGRESMENË DHE ZYRTARË AMERIKANË

F. 5

ABELARD TAHIRI: PAS 9 SHKURTIT KOSOVËS DO T'I RIKTHEHET NORMALITETI

F. 7

MINISTRIA E MBROJTJES: JANË TË PAVËRTETA PRETENDIMET SE KA HUMBUR NDONJËHERË NDONJË DRON

F. 3

EKONOMI



RITJA EKONOMIKE NË KOSOVË KËTË VIT DO TË JETË 3.8 PËR QIND

F. 8

NËNSHKRUHEN DY MARRËVESHJE TË GRANTIT PËR ENERGJI EFIÇIENTE NË PRIZREN ME VLERË 1 MILION EURO

F. 8

SPORT



FERIZAJ MPOSHT GJILANIN, SOT DERBI MALISHEVA - PRISHTINA

F. 10

Trumpi e fajëson Zelenskyn për nisjen e luftës me Rusinë

PRISHTINË, 18 TETOR - Ish-presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, e ka fajësuar presidentin e Ukrainës, Volodymyr Zelensky, se ndihmoi në nisjen e luftës së vendit të tij kundër Rusisë. Kjo deklaratë e Trumpit është sugjerim shtesë se gjasat janë të mëdha që ai do ta ndryshojë rrënjësisht politikën amerikane karshi Rusisë, nëse rizgjidhet president më 5 nëntor.

Kandidati republikan për president e ka kritikuar shpesh Zelenskyn gjatë fushatës së tij zgjedhore, duke e quajtur vazhdimisht "shitësi më i zoti në Tokë", pasi ka kërkuar dhe ka pranuar ndihmë ushtarake nga ShBA-ja në vlerë miliarda dollarë prej se nisi lufta më 2022.

Trumpi e ka kritikuar gjithashtu liderin ukrainas se ka dështuar të kërkojë paqe me Moskën, duke lënë të kuptohet se Ukrainës

mund t'i duhet të pranojë t'i falë tokë Rusisë për të bërë marrëveshje paqeje, gjë që Kievi e vlerëson të papranueshme.

Deklaratat e Trumpit të enjten vonë në PBD Podcast me Patrick Bet-David janë më të ashprat që ai i ka bërë deri tani ndaj liderit ukrainas. Ai tha se Zelensky nuk ka faj vetëm për dështimin për t'i dhënë fund luftës, por sepse ndihmoi në nisjen e saj, pavarësisht se lufta shpërtheu kur Rusia e nisi pushtimin e territorit sovran të Ukrainës. "Kjo nuk nënkupton se unë nuk dua ta ndihmoj atë, sepse ndihem keq për ata njerëz, por ai nuk është dashur të lejonte kurrë që ajo luftë të niste", tha Trump.

Zelensky ia paraqiti Trumpit "planin e fitores" për t'i dhënë fund luftës gjatë një takimi me të në Nju-Jork në shtator. Të dy liderët e cilësuan atë takim si të



ngrohtë.

Megjithatë, deklaratat publike të Trumpit lënë të kuptohet se ai mund ta kufizojë mbështetjen për Ukrainën nëse e mposht kandidaten demokrate Kamala Harris në zgjedhjet e 5 nëntorit. Ai

vazhdimisht ka thënë se mund t'i japë fund luftës në Ukrainë, por nuk ka treguar si do ta bënte një gjë të tillë.

Për dallim nga Trumpi, Harris është zotuar se do ta vazhdojë mbështetjen për Ukrainën nëse

zgjidhet presidente. Ajo ka thënë se fitorja e Ukrainës do të ishte jetike për interesat e sigurisë nacionale të ShBA-së. Harris e ka quajtur shpesh Trumpin pse nuk ngre zërin kundër presidentit rus Vladimir Putin.

A do të ketë ndikim vrasja e udhëheqësit të Hamasit në rrjedhën e luftës në Gazë?

GAZA, 18 TETOR - Vdekja e Yahya Sinwarit, disa muaj pasi u emërua udhëheqës i Hamasit, vë në pah vështirësitë që grupi palestinez, i shpallur terrorist nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian, ka për të mbrojtur nga Izraeli objektivat me vlerë të lartë. Por, vrasja e tij mund të mos ketë ndikim të madh në rrjedhën e luftës në Rripin e Gazës.

Sinwar, 62 vjeç, ishte akuzuar për organizimin dhe drejtimin e sulmit vdekjeprurës të Hamasit ndaj Izraelit më 7 tetor 2023, duke e vendosur atë në krye të listës së armiqve të Izraelit. Izraeli konfirmoi më 17 tetor se



Sinwar u vra në një operacion ushtarak në qytetin jugor të Rafahut në Gazë. Hamas ende nuk ka komentuar.

Vdekja e Sinwarit vë në pah shkallën e lartë të vrasjes së

anëtarëve të lartë të Hamasit, por edhe "mbulimit shumë të thellë të Izraelit, në kuptim të inteligjencës dhe aftësisë për të goditur shpejt kur objektivat me vlerë të lartë detektohen", tha

Lucas Webber, analist i lartë për kërcënimet në Tech Against Terrorism dhe hulumtues në qendrën Soufan.

Koha kur u vra Sinwari, po ashtu është e rëndësishme, tha ai, pasi ndodhi në kohën kur Izraeli po rinovon ofensivën e tij në veri të Gazës dhe po zgjeron operacionet kundër aleatit të Hamasit, Hezbollahut, i cili është grup militant dhe parti politike që kontrollon shumicën e Libanit jugor. "Shihet si një sukses taktik, vrasja e një zyrtari të lartë në një kohë kur atyre u duhet kjo mbështetje e brendshme për zgjerimin e fushatës së tyre ushtarake të

brendshme dhe të jashtme", tha Webberi.

Webberi shtoi se ka dyshime se vdekja e Sinwarit mund të ketë ndikim në dhënien fund të luftës në Gazë. "Ai [Sinwari] sigurisht që kishte shumë përvojë dhe kishte një status të lartë në mesin e Hamasit dhe mbështetësve të tyre, por nuk mendoj se vrasja e tij do ta ndryshojë trajektoren e konfliktit në ndonjë mënyrë thelbësore", tha Webberi.

Sinwar u bë udhëheqës i Hamasit pasi Ismail Haniyeh, shefi politik i grupit, u vra në Teheran më 31 korrik, në një sulm të dyshuar izraelit.

Kim Jong Un e quan Korenë e Jugut shtet të huaj armiqësor

PHENIAN, 18 TETOR - Lideri i Koresë së Veriut, Kim Jong Un, ka thënë të premten se Koreja e Jugut është shtet i huaj armiqësor, raportoi agjencia shtetërore e lajmeve KCNA. Ajo publikoi fotografi të Kimi me ushtarë të rangut të lartë duke e analizuar një hartë të quajtur "Seul" në një post komandues.

Kimi diskutoi për përdorimin e "forcës së ofensive" kundër Jugut si hakmarrje për çdo lëvizje që cenon sovranitetin e Koresë së Veriut, sipas artikullit në KCNA, në të cilin nuk pati shpjegim se çfarë force mund të përdoret.

Një ditë më herët Koreja e Veriut konfirmoi se Kushtetuta e saj e ndryshuar rishtrazi e përcaktonte

Korenë e Jugut si "vend armik" për herë të parë.

Kimi e ka kritikuar vazhdimisht Korenë e Jugut këtë vit, duke e akuzuar se po bashkëpunon me Shtetet e Bashkuara në përpjekje për ta rrëzuar regjimin e tij.

Urdhri i Kimi në janar për ta rishtruar Kushtetutën befasoi shumë ekspertë të huaj, pasi u pa si një eliminim i idesë së shtetësisë së përbashkët ndërmjet Koreve të ndara nga lufta dhe si një shkoputje nga ëndrrat e paraardhësve të tij për ta arritur paqësisht bashkimin e Koreve sipas kushteve të Veriut.

Ajo i shkatërroi lidhjet rrugore dhe hekurudhore me Jugun këtë javë, po ashtu. Këto veprime nënvizojnë "jo vetëm ndarjen fizike, por edhe



fundin e marrëdhënieve të dëmshme me Seul", e citoi KCNA Kimin të ketë thënë.

Seuli ka thënë se, nëse Koreja e Veriut shkakton dëme ndaj popullit të tij, "ajo ditë do të jetë

fundi i regjimit koreanoverior".

Kimi i bëri këto deklarata gjatë inspektimit të selisë së Korpusit të 2-të të ushtrisë koreanoveriore të enjten, tha KCNA. Kjo është njësi e madhe ushtarake që përfshin disa

brigada të vendosura përpara me armë të rënda në drejtim të Koresë së Jugut.

Tensionet mes dy Koreve janë rritur prej kur Veriu filloi të dërgonte balona me mbeturina përtej kufirit në Jug në fund të majit, duke e nxitur Seul të përgjigjet me transmetime propagandistike me altoparantë, gjë që e zemëroi Phenianin.

Koreja e Veriut ka rritur retorikën e saj armiqësore ditët e fundit, duke e akuzuar ushtrinë e Jugut për dërgimin e dronëve mbi kryeqytetin e saj për tri ditë këtë muaj dhe kërcënoi me një "katastrofë të tmerrshme" nëse zbulon një tjetër dron mbi hapësirën e saj ajrore.

Çfarë po ndodh me ushqimin për ushtarët?

Çështja e furnizimit me ushqim për Forcën e Sigurisë së Kosovës është shndërruar në një temë që e ka përplasur së fundi opozitën me partinë në pushtet. Përderisa opozitarët thonë se FSK-ja ka mbetur pa bukë, Ministria e Mbrojtjes argumenton se u përmbahet standardeve të NATO-s sa i përket ushqimit të ushtarëve. Për t'i shmangur pasiguritë në të ardhmen, për shkak të problemeve që mund të shfaqen me kompanitë furnizuese, qeveria tani dëshiron që FSK-ja të ketë vetëqëndrueshmëri sa i përket ushqimit

PRISHTINË, 18 TETOR - Fotografitë e shujtave të pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, të publikuara në medie lokale dhe në rrjete sociale, nxitën debat në sferën publike dhe politike për "menynë e varfër" të ushtarëve. Opozita e akuzoi pushtetin se e ka lënë pa bukë FSK-në, partia qeverisëse - Lëvizja Vetëvendosje - e cilësoi çështjen si propagandë, teksa presidentja e Kosovës kërkoi raport për situatën e krijuar me ushqimin e

ushtarëve. Ministria e Mbrojtjes ngulmoi se ushtarët nuk kanë mbetur pa shujta asnjë ditë të vetme, ndonëse pranoi se përballet me problem të kamotshëm për furnizimin e FSK-së me ushqim. Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, deklaroi se që nga viti 2015 e deri këtë vit, institucioni që udhëheq ka lidhur dhjetë herë radhazi kontrata emergjente për çështjen e ushqimit, të cilat kanë qenë

disamujore dhe janë parë si të dyshimta nga opozita. Kontrata e fundit me furnizues ka skaduar më 30 shtator dhe një tender i ri është anuluar nga Ministria e Mbrojtjes më 11 tetor për shkak të mosmarrëveshjeve në mes të kompanive të shpallura fituese, sipas zëvendësministrit të Mbrojtjes, Shemsi Syla.

Vetëqëndrueshmëria ushqimore

Ai tha për Radion Evropa e Lirë se është vendosur që tani "të kalohet në vetëqëndrueshmëri ushqimore".

Pse? Sipas tij, "vazhdimisht ka pasur ankesa, si dhe pakënaqësi, qoftë për shkak të procedurave të zgjatura tenderuese apo çështjeve të tjera që kanë vënë në pikëpyetje furnizimin me ushqim".

Syla pohoi se Ministria tani ka hapur konkurs "për të rekrutuar staf profesional për përgatitjen dhe shërbimin e ushqimit".

Në konkurs thuhet se Ministria po kërkon 25 kuzhinierë, 23 ndihmëskuzhinierë dhe 42 shpërndarës të ushqimit për ushtarët, për ç'gjë aktualisht po kujdesen kuzhinierët e Qendrës së Studentëve dhe të Shërbimit Korrektues.

Ministri Maqedonci deklaroi se koncepti i vetëqëndrueshmërisë nënkupton kursim të parave dhe siguri në aspektin e furnizimit me ushqim të njëjësive ushtarake, por edhe pavarësim nga operatorët.

Por, opozita argumentoi se ngritja e kapaciteteve për vetëqëndrueshmëri, sa i përket furnizimit me ushqim, mund ta rrezikojë FSK-në.

Disa deputetë, madje, alarmuan se situata aktuale me ushqim është e rëndë dhe se ushtarët rrezikojnë të helmohen.

Standardet e NATO-s

Zëvendësministri Syla shpjegoi për REL-in se FSK-ja u përmbahet standardeve të Organizatës së Traktatit të

Atlantikut Verior (NATO) sa i përket ushqimit për ushtarët, duke u kujdesur për vlerat ushqyese dhe kalorike që duhet të marrin ata përmes ushqimit. Dhe, sipas tij, këto vlera variojnë në bazë të gjendjes aktive të ushtarëve gjatë fazës së trajnimeve, operacioneve, ushtrimeve apo aktiviteteve ditore administrative. Megjithatë, ai pranoi se po punohet që të plotësohet mungesa e disa artikujve, përkatësisht pemëve dhe perimeve.

Shteti fqinj, Mali i Zi, që është pjesë e NATO-s, kujdeset për vlerat ushqyese sipas standardeve specifike të aleancës, duke u ofruar ushtarakeve të vet tri lloje të shujtave: të lëngshme, të thata dhe të përziera. Në grupin e parë përfshihen ushqime të ndryshme, si: perime, mish, ushqime të konservuara, vezë të freskëta e të tjera. Ndërkaq, ushqimet e thata janë ato që kryesisht janë të përgatitura paraprakisht dhe ushtarët i marrin me vete në terren.



Ministria e Mbrojtjes: Janë të pavërteta pretendimet se ka humbur ndonjëherë ndonjë dron

PRISHTINË, 18 TETOR - Ministria e Mbrojtjes përmes një reagimi për medie ka theksuar se Forca e Sigurisë së Kosovës po zhvillohet si një forcë profesionale, e ndërveprueshme me NATO-n dhe e gatshme për t'i kryer detyrat bazuar në mision. Kjo ministri ka theksuar se teksa lajmet e pavërteta përhapen nëpër studio televizive pa kuptuar peshën e fjalës në sigurinë e vendit, i informon qytetarët se të pavërteta janë edhe pretendimet se ka humbur ndonjëherë ndonjë dron. "Asgjë e pavërtetë që

thuhet për të nuk i kontribuon zhvillimit të saj, përkundrazi mbështetë tentativat për minimumin e një pune kolosale brezash, sakrificën e dëshmorëve, veteranëve dhe gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës për formimin e një ushtrie të gatshme për mbrojtje të territorit. Teksa lajmet e pavërteta përhapen nëpër studio televizive pa kuptuar peshën e fjalës në sigurinë e vendit, informojmë qytetarët se të pavërteta janë dhe pretendimet se ka humbur ndonjëherë ndonjë dron. Përkundrazi, flota e dronëve



vëzhgues dhe sulmues është shtuar pas blerjes së parë dhe po vazhdon të shtohet. Kurse

për çështjen e furnizimeve ju sigurojmë që në vazhdimësi pranojmë furnizime me

sisteme të armatimit dhe pajisje ushtarake. Ndeshmëria e procesit të blerjeve dhe furnizimit, ligjërisht kufizon nivelin e informacionit që mund të ndajmë me publikun pa dhënë shumë detaje. Megjithatë janë evidente aktivitetet e shumta të FSK-së ku janë përdorur e përdoren pajisjet dhe sistemet më moderne të armatimit me të cilat FSK është furnizuar dhe po furnizohet vazhdimisht. Të tjera po vijnë, dhe të gjitha sipas standardeve të NATO-s", është thënë në reagimin e kësaj ministrie.



Çështja e Kosovës dhe politika e jashtme, faktorë për votën e shqiptaro-amerikanëve në Miçigan

PRISHTINË, 18 TETOR - Kanë mbetur më pak se tri javë nga dita e zgjedhjeve presidenciale të 5 nëntorit në Shtetet e Bashkuara. Anketat e fundit tregojnë se gara mes dy kandidatëve, demokrates Kamala Harris dhe republikanit Donald Trump, është tepër e ngushtë. Rol vendimtar në këto zgjedhje pritet të luajnë shtatë shtete të pavendosura, mes tyre Miçigani, ku jeton komuniteti i dytë më i madh i shqiptaro-amerikanëve në ShBA, pas Nju-Jorkut.

Ekipet elektorale të ish-presidentit Trump dhe nënpresidentes Harris po përpiqen ta sigurojnë votën e shqiptaro-amerikanëve.

Gazetarja Keida Kostreci bisedoi me pjesëtarë të këtij komuniteti në Miçigan mbi ndikimin që mund të ketë politika e jashtme e dy kandidatëve, sidomos për çështjen e Kosovës, te vota e tyre. Imam Shuajb Gërguri i Qendrës Islame Shqiptare në Miçigan dëgjon shpesh shqetësimet e besimtarëve të kësaj qendre dhe thotë sa ata kanë prirje të ndryshme politike, por në një pikë janë në emërues të përbashkët. "Gjëja tjetër që është e rëndësishme për shqiptarët, përveç ekonomisë që mund ta ketë vendin e parë, është edhe qëndrimi partiak në lidhje me

çështjen e Kosovës. Pra qëndrimi, apo deklarimi haptas se si do të jenë, apo çfarë do të bëjnë për Kosovën, mund të jetë përcaktues se çfarë krahu do të marrin shqiptarët dhe nga do të votojnë në këto zgjedhje", thotë ai për "Zërin e Amerikës".

Imam Gërguri thotë se duke pasur parasysh rolin e ish-presidentit demokrat Bill Clinton për ndërhyrjen e NATO-s në ndaljen e spastrimit etnik në Kosovë dhe veprimet e demokratëve të tjerë më pas, ka një lidhje mes komunitetit dhe demokratëve në Shtetet e Bashkuara.

Politika e Uashingtonit ndaj Ballkanit Perëndimor ka qenë në përgjithësi dypartiake. Kosova u njoh nga Shtetet e Bashkuara gjatë administratës së ish-presidentit republikan George W. Bush dhe politikanë me peshë që kanë mbështetur Kosovën përfshijnë si demokratë edhe republikanë. Valentin Lumaj, një aktivist shqiptaro-amerikan, i angazhuar me fushatën e ish-presidentit Donald Trump, bie dakord se realiteti në Kosovë do të jetë një nga faktorët që do ta përcaktojë vullnetin e shqiptaro-amerikanëve. "Disa votojnë si amerikanë, por disa e kanë lidhur shumë qasjen shqiptare me vendin e tyre si patriotë që janë

dhe dëshirojnë të votojnë për një person që premton më shumë për liritë dhe pavarësinë dhe njohjen e Kosovës më gjerë dhe garanton kufijtë e saj", thotë ai për "Zërin e Amerikës".

Por imami thotë se administrata e Trumpit dukej se anonte nga Serbia kur bëhet fjalë për dialogun për marrëveshje mes dy vendeve. Gjatë administratës aktuale të presidentit Joe Biden, procesi i dialogut mes Kosovës dhe Serbisë nuk ka shënuar përparim dhe marrëdhëniet e Prishtinës me Uashingtonin janë në pikën më të ulët që kur Kosova shpalli pavarësinë, për shkak të atyre që zyrtarët amerikanë i kanë karakterizuar si veprime të njëanshme dhe të pakoordinuara të qeverisë së kryeministrit Albin Kurti.

Aktivistja shqiptaro-amerikane Afërdita Rakipi, një demokrate, thotë për "Zërin e Amerikës" se ndaj Ballkanit, Shtetet e Bashkuara kanë ndjekur një politikë dypalëshe. "Nuk ka qenë as e republikanëve, as e demokratëve, sepse kemi pasur lëvizje, edhe mbështetje nga të dyja anët. Pavarësisht se kush shkon në Shtëpinë e Bardhë, Kongresi ka edhe demokratë edhe republikanë. Kështu që çështja shqiptare ka qenë kurdoherë

bilaterale", thotë ajo.

Imami Shuajb Gërguri thotë se Shtetet e Bashkuara janë të përqendruara te konfliktet e tjera madhore në botë si lufta në Ukrainë dhe konflikti në Lindjen e Mesme, gjë që mund të lërë në hije çështjen e Kosovës. "Problemi si e shohim ne është që sot jetojmë në një kohë kur ka vatra të nxehta dhe shumë më të rëndësishme sesa Kosova në botë. Amerika është e zënë me punë të tjera kështu që ne mund të jemi viktimitë".

Demokratja Kamala Harris dhe republikani Trump kanë qëndrime të ndryshme lidhur me Ukrainën.

Nënpresidentja Harris ka premtuar se do ta vazhdojë mbështetjen e Kievit përballë agresionit të Rusisë.

Ish-presidenti Trump e ka akuzuar administratën e presidentit Joe Biden se ka zgjidhur luftën dhe thotë se po të ishte ai president do t'i jepte fund asaj "brenda 24 orësh" duke përmendur "marrëdhëniet e mira" me presidentin rus Vladimir Putin, por pa dhënë detaje për një plan në këtë drejtim.

Disa votues shqiptaro-amerikanë, si Esmeralda Demiraj, e vlerësojnë këtë qëndrim. "Mua më pëlqen shumë ajo që tha presidenti

Trump, për 24 orë bëj një telefonatë dhe mbyll luftën. Dhe unë dua ta besoj shumë dhe të shpresoj që të ndodhë ajo", thotë ajo për "Zërin e Amerikës".

E pyetur nëse e shqetëson fakti që Trumpi ka shprehur admirim për figura si Vladimir Putin dhe Viktor Orban, ajo thotë se e sheh qëndrimin e tij si "diplomatik".

Por demokratja Rakipi thotë se e shqetësojnë shumë qëndrime të tilla që ajo thotë se nuk janë të përshtatshme për një udhëheqës ose kandidat. "Çfarë të mire mund të kemi ne, si amerikanë, si shqiptaro-amerikanë kur ky (Trump) i ka këta shokë, kur çdo udhëheqës tjetër qoftë republikan, edhe demokrat, ka pasur kujdes në marrëdhëniet ndërkombëtare, në këto çështje?", thotë ajo.

Lufta në Lindjen e Mesme është një faktor tjetër në votimet e këtij viti. Imam Gërguri thotë se ajo që po ndodh në Gazë do të ndikojë te një pjesë e anëtarëve të qendrës islame që ai drejton.

Në një shtet si Miçigani, ku gara këtë vit është e ngushtë dhe çdo votë ka rëndësi, zgjedhja e shqiptaro-amerikanëve, një komunitet prej dhjetëra-mijëra vetash, pritet të jetë e rëndësishme për ta përcaktuar fituesin.

Haradinaj udhëton në ShBA, paralajmëron takime me kongresmenë dhe zyrtarë amerikanë

PRISHTINË, 18 TETOR - Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka udhëtuar për vizitë zyrtare drejt ShBA-së, i shoqëruar nga shefi i grupit parlamentar, deputeti Besnik Tahiri, ka bërë me dije zëdhënësi i AAK-së, Kushtrim Xhemaili, për gazetën "Express". Ai tha se Haradinaj do ta fillojë vizitën në Chicago, ku do të qëndrojë me ftesë të Universitetit të Chicagos -

"Instituti Pearson", në konferencën globale, ku do të flasë për zhvillimet në Kosovë dhe rrugëtimin e Kosovës që nga liria e deri më sot. Po ashtu, Haradinaj në Chicago do të takojë një pjesë të komunitetit shqiptar. "Vizitën në ShBA ai do ta vazhdojë në Nju-Jork, ku do të pritë nga Federata Panshqiptare 'Vatra' dhe do ta takojë komunitetin shqiptaro-amerikan. Gjatë

qëndrimit në Nju-Jork, z. Haradinaj do të takojë kongresmenë dhe zyrtarë të tjerë të shtetit. Vizitën zyrtare z. Haradinaj do ta përmbyllë në Uashington, ku do të zhvillojë takime zyrtare në tri institucionet kryesore: Pentagon, Departamentin e Shtetit Amerikan dhe Këshillin e Sigurisë Kombëtare të Shtëpisë së Bardhë", tha Xhemaili.



Raundi i ri i dialogut Kosovë - Serbi, javën e ardhshme

PRISHTINË, 18 TETOR - Javën e ardhshme, sipas të gjitha gjasave, të enjten, më 24 tetor, në Bruksel pritet të zhvillohet raundi i ri i takimeve në kuadër të dialogut për normalizim të raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë në nivel të kryenegociatorëve. Kështu thanë burimet diplomatike të Radios Evropa e Lirë në Bashkimin Evropian, pa dhënë hollësi për takimet. Në BE gjithmonë e përdorin fjalën "takime", pasi nuk janë të

sigurt nëse do të ketë takim trepalësh, pra takim mes dy delegacioneve në prani të lehtësuesit nga BE-ja. Deri më tani zakonisht janë zhvilluar takime dypalëshe mes të dërguarit të BE-së për dialogun, Miroslav Lajçak, dhe kryenegociatorit të Kosovës dhe atij të Serbisë, por jo edhe takime trepalëshe. Herën e fundit kur është zhvilluar një takim trepalësh ka qenë takimi i 2 korrikut të këtij viti.

Megjithatë, pas takimit palët dolën me qëndrime diametralisht të kundërta rreth asaj që kishte ndodhur në takime. Palët e kishin akuzuar njëra-tjetrën për "mungesë të gatishmërisë për dialog". Ditët e fundit Lajçaku ka mbajtur konsultime me palët, por përpos pohimeve se po shqyrtohet rruga përpara në dialog, nga ana e BE-së që ndërmjetëson këtë proces që ka nisur më 2011 - nuk kanë dhënë hollësi se me cilat tema do

të merren palët në takimet e radhës. Në BE, por edhe në NATO, gjithnjë e më shumë po shprehin pakënaqësi lidhur me rrjedhën aktuale të dialogut, duke thënë se procesi nuk po prodhon rezultatet e pritura. Kështu ka konstatuar edhe sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, duke shprehur shqetësim për këtë. Emisari evropian për dialogun, Miroslav Lajçak, ka mandat në këtë post deri në fund të muajit

janar të vitit 2025. Ndërkaq, në BE presin të shohin se çfarë qasje rreth dialogut do të ketë përfaqësuesja e re e lartë për politikë të jashtme, Kaja Kallas, pasi ta marrë mandatin. Mandati i saj do të nisë kur të jetë gati i tërë ekipi i ri i Komisionit Evropian, pasi të konfirmohet nga Parlamenti Evropian. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka deklaruar se pret dinamikë të re nga Komisioni Evropian sa i përket dialogut.



Rohde: Procesi i Berlinit mbetet mjet në rrugën e integrimit në BE përmes bashkëpunimit rajonal

PRISHTINË, 18 TETOR - Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde, të premten, në një debat të organizuar në Prishtinë, ka folur për Procesin e Berlinit dhe një dekadë punë në këtë proces për afrimin e Ballkanit Perëndimor me BE-në. Ai ka shtuar se Procesi i

Berlinit mbetet kyç për integrimin e Kosovës në BE përmes bashkëpunimit rajonal. Rohde ka thënë se mbesin edhe shumë mundësi të tjera për t'u zhbllokuar, derisa thotë se indikatorët tregojnë se ende s'janë plotësuar të gjitha pritjet. "Duke parë para

në 10 vitet e Procesit të Berlinit: Është arritur shumë, por shumë mundësi mbeten për t'u zhbllokuar. Jo të gjithë treguesit i kanë përmbyshur ende pritjet. Procesi i Berlinit mbetet një mjet kyç që plotëson rrugën e integrimit në BE përmes bashkëpunimit rajonal", ka thënë Rohde.



Demagogët në Ballkanin Perëndimor dhe të drejtat e popujve për liri dhe pavarësi



Shkruan:
Prof. dr. Fejzulla
BERISHA

Demagogjia në Ballkanin Perëndimor ka përfaqësuar dy fenomene të ndërlidhura që shpesh kanë ecur krah për krah në periudhat e ndryshimeve të mëdha politike, sociale dhe etnike. Ky rajon ka përjetuar lëvizje të fuqishme për demokraci-pavarësi, konflikte të dhunshme etnike dhe ndërhyrje ndërkombëtare, ku demagogjia ka luajtur një rol kyç në manipulimin e opinionit publik dhe formësimin e tij. Demagogjia është një formë udhëheqjeje politike ku liderët, për përfitime personale ose politike afatshkurtra, përdorin retorikë populiste, emocionale dhe shpesh të mbushur me dezinformata.

Me historinë e ndarjeve etnike, fetare dhe kombëtare, Ballkani Perëndimor ka qenë një terren pjellor për demagogji. Shembujt më të spikatur përfshijnë liderët politikë të periudhës së shpërbërjes së Jugosllavisë, si Slobodan Millosheviqi në Serbi dhe Franjo Tugimani në Kroaci, si dhe udhëheqësit në Bosnjë e Hercegovinë, Maqedoni dhe Shqipëri. Këta udhëheqës përdorën retorikë nacionaliste për të mobilizuar popullsinë, shpesh duke përshkallëzuar tensionet etnike. Për shembull, Millosheviqi nxit frikën e serbëve nga humbja e fuqisë në ish-Jugosllavi për të justifikuar agresionin ndaj Kosovës, Bosnjës dhe Kroacisë. Ndërkohë, Tugimani përdori demagogjinë për të bashkuar kroatët dhe për të ndërtuar një identitet kombëtar të veçantë, shpesh në dëm të bashkëjetesës etnike në Kroaci.

Nga shpallja e pavarësisë së Shqipërisë në vitin 1912 deri të lufta për pavarësinë e Kosovës në fund të viteve 1990, popujt e Ballkanit kanë kërkuar vazhdimisht njohjen e të drejtave të tyre për vetëvendosje. E drejta për liri dhe pavarësi njihet ndërkombëtarisht dhe është sanksionuar në dokumente si Karta e Kombeve të Bashkuara (1945) dhe Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (1948), etj. Ky parim thekson se çdo popull ka të drejtën për të vendosur për fatin e tij, përfshirë krijimin e një shteti të pavarur kur është e nevojshme. Rasti i Kosovës është një shembull suigeneris i një populli që kërkoi vetëvendosje pas dekadash represioni dhe konflikti.

Lufta e Kosovës (1998-1999) dhe ndërhyrja ndërkombëtare e udhëhequr nga NATO janë shembuj të përpjekjeve për të fituar lirinë.

Pavarësia e Kosovës u shpall më 17 shkurt 2008 dhe ka marrë njohje ndërkombëtare të gjerë, megjithëse ende kundërshtohet nga disa vende në Ballkan dhe më gjerë. Një nga sfidat kryesore në Ballkan ka qenë përplasja mes demagogjisë dhe përpjekjeve të sinqerta për pavarësi dhe demokraci.

Udhëheqësit demagogjikë shpesh kanë shfrytëzuar lëvizjet për pavarësi për qëllime personale, duke penguar proceset demokratike dhe përkeqësuar ndarjet etnike. Në shumë raste, këto lëvizje kanë shkaktuar konflikte të përgjakshme dhe kriza humanitare.

Edhe pse demagogët pretendojnë se veprojnë në emër të popullit, veprimet e tyre janë zakonisht të motivuara nga ruajtja e pushtetit personal. Ndikimi i faktorit ndërkombëtar ka qenë gjithashtu vendimtar në proceset e pavarësisë dhe lirisë në Ballkan. Megjithatë, edhe ndërhyrjet e huaja nuk kanë qenë të lira nga ndikimi i demagogëve, siç shihet nga mbështetja e Rosisë për lëvizjet nacionaliste serbe dhe kundërshtimi ndaj pavarësisë së Kosovës.

Demagogjia dhe e drejta e popujve për liri në Ballkanin Perëndimor kanë një marrëdhënie komplekse dhe shpesh të tensionuar. Ndërsa popujt e rajonit kanë kërkuar vazhdimisht pavarësi dhe vetëvendosje, demagogjia ka penguar përparimin e tyre drejt demokracisë dhe paqes.

Kur populistët dhe dogmatët vijnë në pushtet dhe përfaqësojnë shtetin, ata shpesh përdorin kartën e populizmit për të shmangur përballjen me sfidat kombëtare që kërkojnë guxim dhe aftësi. Në vend që të adresojnë problemet reale dhe komplekse që prekin shoqërinë, ata i drejtohen retorikës populiste për të fituar mbështetje të shpejtë. Kjo retorikë shpesh përqendrohet në ngritjen e ndjenjave nacionaliste, krijimin e një armiku të përbashkët, dhe dhënien e premtimeve të mëdha pa mbështetje praktike. Përmes kësaj taktike, ata shmangin përballjen me realitetin dhe sfidat kombëtare që kërkojnë zgjidhje të përgjegjshme dhe afatgjata. Ky veprim dëmton proceset demokratike dhe ngadalëson zhvillimin e vendit, duke thelluar ndarjet shoqërore dhe krijuar tensione që shpesh degjenerojnë në konflikte të panevojshme.

Populizmi, në këto raste, bëhet një mjet për të shmangur llogaridhënien dhe për të

manipuluar emocionet e publikut, duke u fokusuar te përfitimet afatshkurtra në vend të zgjidhjeve të qëndrueshme.

Rajoni i Ballkanit Perëndimor vazhdon të përballet me pasojat e nacionalizmit ekstrem dhe manipulimeve politike që kanë penguar përpjekjet legjitime për liri dhe përparim. Për të luftuar këtë fenomen, disa masa konkrete janë të domosdoshme: a. Një qytetar i mirëinformuar është më i aftë të dallojë retorikën boshe dhe manipulimet politike. Edukimi është thelbësor për të ndihmuar qytetarët të kuptojnë politikën reale dhe të mos bienin pre e demagogjisë. b. Mediat luajnë një rol kyç në ekspozimin e demagogjisë dhe manipulimit politik. Qytetarët duhet të kërkojnë burime të besueshme informacioni dhe të shmangin mediat që promovojnë agjenda të njëanshme. c. Qytetarët mund të sigurojnë transparencë dhe llogaridhënie nga liderët përmes pjesëmarrjes aktive në zgjedhje dhe në proceset demokratike. d. Këto organizata luajnë një rol të rëndësishëm në sfidimin e politikave demagogjike dhe në

promovimin e dialogut politik konstruktiv, duke nxitur zhvillimin e demokracisë. e. Qytetarët dhe mediat duhet të kërkojnë politika që bazohen në fakte dhe analiza të qëndrueshme, duke shmangur retorikën populiste që synon përfitime afatshkurtra.

Liderët dogmatikë në Ballkanin Perëndimor kanë pasur fate të ndryshme, të ndikuara nga rrethanat politike dhe sociale të periudhës pas sundimit të tyre. Megjithatë, disa modele të përgjithshme janë të dukshme: - Liderët dogmatikë shpesh përfundojnë të izoluar kur retorika e tyre ekstreme humbet ndikimin. Nëse ata nuk arrijnë të përmbushin premtimet populiste ose nuk ruajnë mbështetjen e qëndrueshme të publikut dhe elitave politike, ata gradualisht largohen nga qendra e pushtetit. - Në disa raste, liderët janë rrëzuar nga pushteti përmes lëvizjeve popullore apo revolucionare. Kur situata politike dhe ekonomike përkeqësohet, qytetarët shpesh organizojnë protesta masive për të kërkuar ndryshime, duke e detyruar liderët të largohet. -

Shumë liderë dogmatikë në Ballkan, si Slobodan Millosheviqi dhe Radovan Karagjiqi, janë ndjekur penalisht për krime lufte ose shkelje të të drejtave të njeriut. Ndjekjet penale për liderët aktual si Aleksandar Vuçiq dhe Milorad Dodik janë shembuj të vazhimit të kësaj praktike, pasi ata akuzohen për abuzim me pushtetin dhe për shtypjen e të drejtave të qytetarëve. - Disa liderë përfundojnë duke ikur nga vendi për të shmangur ndjekjet penale ose ndëshkimin politik. Ata përpiqen të ruajnë ndikimin jashtë, por zakonisht fuqia e tyre bie ndjeshëm pas largimit.

“Rrëzimi i heshtur” i qeverive dogmatike: Ky koncept përfshin ndryshimin gradual të regjimeve të ngurtësuar në ideologji. Në vend të revolucioneve të dhunshme, këto regjime rrëzohen përmes konsumimit politik, humbjes së mbështetjes publike, rezistencës paqësore, dhe presionit diplomatik e ekonomik. Ndryshimi vjen kur institucionet vendase ose ndërkombëtare marginalizojnë ose injorojnë liderët, derisa ata humbasin legjitimitetin dhe pushtetin.



Abelard Tahiri: Pas 9 shkurtit Kosovës do t'i rikthehet normaliteti

PRISHTINË, 18 TETOR - Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, ka thënë se tentimi për ta kufizuar lirinë e shprehjes është tipari i përbashkët i të gjitha tendencave totalitare. Ai ka theksuar se për pushtetin e kapelave të zeza, ndalimi i fjalës së lirë nuk është thjesht ambicie, por edhe detyrë. "Sepse duke kontrolluar forumin ku transmetohet fjala, ata synojnë t'i ikin

ekspozimit dhe përgjegjësisë. Kësisoj, pushteti i kapelave të zeza e ka zhvilluar një raport të tillë përballë medie, veçanërisht ndaj RTK-së. Një RTK që do të duhej të ishte në funksion të publikut dhe fjalës së lirë, na i mbylli dyert dhe transmetimin pikërisht nga frika e pushtetit. Si akt, ka ndodhur pardje. Si metodë, ka ndodhur që prej ditës së parë të qeverisjes së Vetëvendosjes. Si tendencë,

po ndodhë edhe sot dhe synon të vazhdojë edhe më tej, derisa të fusë nën kthetra çdo forum ku flitet hapur dhe kritikohet arsyeshëm", ka shkruar Tahiri në "Facebook". Ai ka thënë se fjalën e lirë nuk do të mund ta mbysin. "Pas 9 shkurtit Kosovës do t'i rikthehet normaliteti, e RTK-së fisnikëria në misionin e vet si transmetues publik", ka shkruar Tahiri.



Fusha "Biznes, administratë dhe ligj" vazhdon të jetë më e preferuara për studentët e rinj

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 18 TETOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar statistikat e arsimit të lartë sipas fushave të studimit për vitin akademik 2023/2024. Fusha e studimit "Biznes, administratë dhe ligj" vazhdon të mbetet fusha më e pëlqyer e studentëve në nivelin bachelor me gjithsej 4 380 studentë, ose 26,4 % e numrit të përgjithshëm të studentëve të regjistruar.

Ndërsa numër më i vogël i studentëve kanë zgjedhur të studiojnë në fushën "Bujqësi, pylltari, peshkim dhe veterinar" me gjithsej 381 të regjistruar, ose 2,3 %.


Në fushën "Teknologjia Informatike dhe Komunikimi (TIK)" për vitin akademik 2023/2024 në nivelin bachelor, meshkujt përbëjnë 62,2 % të numrit të përgjithshëm të

studentëve, ndërsa femrat janë me 37,8 % të numrit të përgjithshëm. Krahasuar me vitin paraprak 2022/2023, ka një rritje të numrit të femrave në këtë fushë.

Interesim më i madh i studentëve në nivelin master në fushën "Biznes, administratë dhe ligj" në universitete publike dhe kolegje private

Edhe te niveli master, fusha "Biznes, administratë dhe ligj" vazhdon të mbetet fusha më e preferuar e regjistrimeve të studentëve, ku janë regjistruar 1 314 studentë ose 34 % e numrit të përgjithshëm. Ndërsa numër më i vogël i studentëve të regjistruar kanë zgjedhur të studiojnë në fushën "Bujqësi, pylltari, peshkim dhe veterinar", me gjithsej 81 studentë, ose 2,1 % e numrit të përgjithshëm.

Krahasuar me numrin e përgjithshëm të studentëve, të cilët ndjekin arsimin e lartë në



nivelin master, dominon numri i studentëve të cilët ndjekin studimet në fushat "Biznes, administratë dhe ligj" me gjithsej

3 208 studentë të regjistruar ose 32,5 % e numrit të përgjithshëm. Diferencë më e madhe gjinore vërehet edhe te niveli master në

fushën e "Arsimit", ku nga 425 studentë, 92 % janë femra dhe 8 % janë meshkuj (vetëm 34 studentë meshkuj).

Gërvalla merr pjesë në konferencën për veprimin ndaj minave



PRISHTINË, 18 TETOR - Duke folur për rëndësinë e veprimeve ndaj minave në Ukrainë, në konferencën e mbajtur në Lozanë të Zvicrës, me ftesë të ministrit të Jashtëm të Zvicrës, Ignazio Cassis, zëvendëskryeministria dhe ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla, tha se, krahas rëndësisë së strategjive për çminim, fitorja e Ukrainës dhe ndalja e luftës janë vendimtare për paqen dhe stabilitetin në Evropë dhe më

gjerë. Ministria Gërvalla theksoi përkushtimin e Kosovës për të kontribuar jo vetëm në sigurinë e brendshme, por edhe në misionet ndërkombëtare, duke përdorur përvojën e Kosovës për çminimin e zonave të minuara dhe mbështetjen për luftën e Ukrainës kundër agresionit rus. Ministria Gërvalla theksoi urgjencën e përfundimit të luftës në Ukrainë, duke paralajmëruar se bashkësia ndërkombëtare po

dështon çdo ditë që kjo luftë vazhdon. "Edhe nëse kjo luftë do të ndalej sot, bashkësisë ndërkombëtare do t'i duhet të merrej edhe për vite të tëra me pasojat e kësaj lufte, me të mbijetuarit, viktimat dhe rindërtimin e Ukrainës. Por lufta nuk po ndalet sot, prandaj është e domosdoshme që bashkësia ndërkombëtare të bëjë gjithçka që është e nevojshme për ta ndaluar këtë luftë tani", tha Gërvalla.

Filloi nënshkrimi i kontratave për gjeneratën e 61 të kadetëve policorë

Prishtinë, 18 tetor - Më 17 dhe 18 tetor Policia e Kosovës, Departamenti për Burime Njerëzore, pas përfundimit të të gjitha procedurave të parapara dhe publikimit të listës përfundimtare për kadetë policorë, ka organizuar procesin e nënshkrimit të kontratave për marrëdhënie

të punës me Policinë e Kosovës për kadetë policorë të gjeneratës së 61-të. Për rëndësinë e të qenit polic i Republikës së Kosovës, për detyrat që i presin fillimisht në Akademi e më pas edhe në punën policore, kadetëve iu folën eprorë të lartë të Departamentit për Burime Njerëzore.

Kjo gjeneratë, ashtu sikurse dhe gjeneratat e tjera të PK-së, në përbërjen e saj ka një përfshirje shumëtnike të komuniteteve të Republikës së Kosovës dhe e njëjta pritet të fillojë trajnimin themelor në AKSP pas përfundimit të procedurës së nënshkrimit të kontratave.



Rritja ekonomike në Kosovë këtë vit do të jetë 3.8 për qind

PRISHTINË, 18 TETOR - Banka Botërore ka parashikuar që rritja ekonomike në Kosovë këtë vit do të jetë 3.8 për qind, ndërkaq trendi i rritjes do të vazhdojë edhe më 2025 në 3.9 dhe një vit më vonë në 4 për qind. Paraprakisht, rritje prej rreth 4-përqindësh për këtë vit kanë parashikuar edhe autoritetet e Kosovës dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar. Megjithatë, njohësit e fushës së ekonomisë kanë thënë se që rritja ekonomike të ndikojë në rritjen e mirëqenies së qytetarëve duhet të jetë në shifra dyshifrore.

Në raportin e Bankës Botërore u tha se parashihet rritje ekonomike për gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor - Kosovën, Shqipërinë, Bosnjë-Hercegovinën, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë, që vitin 2025 do të arrijë në 3.7 për qind apo 0.2 pikë të përqindjes më e lartë sesa paraprakisht ishte parashikuar. "Faktorët e brendshëm vijnë të mbështesin një përsheptim me ritëm të moderuar të rritjes ekonomike në Ballkanin Perëndimor. Përveç kësaj, në periudhë afatmesme, rimëkëmbja graduale e aktivitetit ekonomik në Bashkimin Evropian pritet të luajë rol vendimtar në

forcimin e eksporteve të rajonit", tha Isolina Rossi, ekonomiste në Bankën Botërore dhe autore kryesore e raportit.

"Pavarësisht prej perspektivës pozitive, rajoni vijon të mbetet i ekspozuar ndaj një sërë rreziqesh, si rritja e ngadaltë ekonomike në nivel global, kthimi i inflacionit sërish në nivele të larta, pasiguritë politike dhe ngjarjet ekstreme të motit", shtoi ajo.

Banka Botërore tha se me rritjen ekonomike në Ballkanin Perëndimor, standardet e jetesës në rajon "po vijnë të konvergojnë gradualisht me ato të ekonomive më të përparuara të Bashkimit Evropian". Megjithatë, kjo organizatë tha se që të ruhet vullti i rritjes ekonomike kërkohet përsheptimi i reformave strukturore, përfshirë ato që parashihen në kuadër të Planit të Rritjes të BE-së. "Për ta mbështetur këtë rritje ekonomike, vendet e rajonit duhet ta forcojnë tregtinë rajonale dhe me Bashkimin Evropian, ta reduktojnë kohën e pritjes në kufi dhe t'i integrojnë sistemet e pagesave", tha Xiaoqing Yu, drejtoreshë e Bankës Botërore për Ballkanin Perëndimor. Plani i rritjes për Ballkanin



Perëndimor është miratuar nga BE-ja në maj dhe kap vlerën e 6 miliardë eurove. Ky plan synon t'i mbështesë reformat e rajonit, që lidhen me BE-në si dhe rritjen e tij ekonomike.

Vendet anëtare të BE-së i miratuan më 11 tetor agjendat e reformave të pesë vendeve të

rajonit - përveç Bosnjë-Hercegovinës - duke i hapur kështu rrugë Komisionit Evropian që t'i bëjë pagesat e para nga paketa në fjalë.

Bosnja duhet të presë ende për miratimin e agjendës së saj, pasi dokumenti që ky vend dërgoi në BE, nuk ishte komplet dhe nuk i

adresonte të gjitha sugjerimet e dhëna nga Komisioni Evropian. Sipas një përlogaritje jozyrtare, Kosova do të mund të përfitojë mbi 880 milionë euro nga Plani i Rritjes. Mbi 250 milionë euro, asaj do t'i ndaheshin si para pa kthim, ndërsa pjesa tjetër në formën e kredive të volitshme.

Nënshkruhen dy marrëveshje të grantit për energji eficiente në Prizren me vlerë 1 milion euro



Prishtinë, 18 tetor - Të premtën u nënshkruan dy marrëveshje të grantit në kuadër të projektit "Energjia efiçente në ndërtesat publike në Prizren", me vlerë totale prej një milion eurosh. Projekti në fjalë parashihet rindërtimin, rehabilitimin dhe renovimin e rreth 100 ndërtesave publike, përfshirë qendra të mjekësisë familjare, çerdhe dhe shkolla, me qëllim të garantimit të kushteve më të përshtatshme për qytetarët dhe punonjësit që shfrytëzojnë këto hapësira publike si dhe për të kontribuar në kursimin e energjisë.

Në ceremoninë e nënshkrimit ishin të pranishëm ministri i Financave, Punës dhe

Transfereve, Hekuran Murati, drejtori i Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim në Kosovë, Sergiy Maslichenko, dhe nënkryetari i komunës së Prizrenit, Kujtim Gashi. Gjatë këtij takimi u nënshkrua marrëveshja e grantit ndërmjet BERZH dhe MFPT, si dhe marrëveshja e nëngrantit, e cila parashikon kalimin e fondeve në komunën e Prizrenit për zbatimin e projektit në fjalë.

Vlen të theksohet se marrëveshjet e nënshkruara sot vijnë pas një marrëveshjeje të ratifikuar vitin e kaluar për të njëjtin projekt, e cila kishte një vlerë prej 5 milionë eurosh, duke e bërë vlerën totale të marrëveshjeve 6 milionë euro.

Shpërthimi në Kosova A, KEK-u: Zjarri është lokalizuar, nuk ka vend për shqetësim

Prishtinë, 18 tetor - Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) ka thënë se nuk ka vend për shqetësim në lidhje me operimin dhe sigurinë në njësitë e TC Kosova A.

Në reagim thuhet se Njësia A4 është ndalur për shkak të një lidhjeje të shkurtër në kabllo të matjeve dhe është shkëputur nga puna në mënyrë të rregullt.

"Korporata Energjetike e Kosovës (KEK sh.a.) njofton opinionin se nuk ka vend për shqetësim në

lidhje me operimin dhe sigurinë në njësitë e TC Kosova A. Njësia A4 është ndalur për shkak të një lidhjeje të shkurtër në kabllo të matjeve, dhe është çkyçur nga puna në mënyrë të rregullt. Ekipet e mirëmbajtjes janë angazhuar që nga momenti i ndaljes së njësisë dhe po punojnë për sanimin e gjendjes, me qëllim që njësia të kthehet në operim sa më shpejt. Zjarri i raportuar në media ka ndodhur jashtë

njësisë A4 dhe i njëjti është lokalizuar dhe fikur në kohë optimale nga zjarrfikësit. Korporata Energjetike e Kosovës fton të gjitha mediat dhe palët e interesit që në raste të tilla të kërkojnë informacione zyrtare nga KEK, për të evituar krijimin e panikut përmes lajmeve të pavërteta. Kjo është e rëndësishme për të siguruar që opinionin publik të jetë i informuar saktë", ka njoftuar KEK-u.



Rrjetet sociale: Cirku i zilisë, luksit, dukjes

Mediat sociale janë një vitrinë e mrekullueshme virtuale ku të gjithë, madje edhe përdoruesit me 100 ndjekësa, jo vetëm influencersit, duket se kanë jetën perfekte. Ose të paktën ata zgjedhin me kujdes se çfarë të ndajnë për jetën e tyre, duke u përpjekur t'i japin pamjen më rozë të mundshme. Ose më të lakmueshme.

Nuk ka asgjë të keqe të ndash gjëra të çmuara dhe momente të bukura. Ndoshta nëse do të flisnim me një antropolog, do të gjenim gjurmë të këtyre sjelljeve edhe te njerëzit e shpellave. Eshhtë një sjellje shumë njerëzore.

Me që ra fjala tek shpellat, a e mban mend Facebook-un në kulmin e tij? Ishte viti 2008, kur i mbushnim postimet me fotografi perëndimesh të mahnitshme, monumentesh të kapura nga disa kënde. E bënim për të ndarë kënaqësinë, apo për t'u bërë të lakmueshëm?

Ndërsa sot, rrjetet sociale të sotme kanë pësuar një përmirësim ose përqendrim, në varësi të këndvështrimit. Shumë influencers të viteve 2000 e shndërruan ndarjen e gjërave të bukura në një obsesion të vërtetë, duke kufirin çdo ditë pak më tutje. Dhe tani, postimi në rrjetet sociale është kthyer në një formë komunikimi të ethshëm, që po bie ndesh me shijet, parimet dhe emocionet e një pjese të publikut.

Nuk është më e qartë se sa është strategji dhe sa fshihet një shkëputje nga bota reale me gjithë shëmtinë dhe kontradiktat e saj. Dhe kështu për këta njerëz bëhet normale që të priten falas në një hotel me 5 yje sepse u prishet kondicioneri në shtëpi, apo të kujtohen se kanë harruar një çantë 3000 euro në gardërobë. Nga i dimë ne këto gjëra?

Sepse kanë qenë vetë ata që na i kanë rrëfyer në rrjetet sociale. Shkëputja nga realiteti qëndron në të menduarit se krijimi i përmbajtjes është një ide e mirë. Jeta bombastike e disa influencersve po arrin padyshim nivele groteske, por mos u gënjoni nga filluska. Bashkëpunimet e shumta me të cilat mburren dhe ndjekësit e tyre adhuroes, tregojnë se gjërat po u ecin ende shumë mirë. Pushime në hotele me pishina përrallore. Udhëtime në klasin e parë, dreka dhe darka në restorante të famshme. Gjithçka për dukje dhe ... para.

Një cirk i vërtetë ekspozimi, ku çdo postim është një tryezë e artë dhe çdo histori një akrobaci përsosmërie. Po ndjekësit, ku janë në gjithë këtë cirk? Si ka ndryshuar marrëdhënia e tyre me këtë lloj influencersi, me kalimin e kohës?

Faza 1. Lejuan të mashtroheshin, të bindur se pas asaj atmosfere përsosmërie kishte një mundësi edhe për ta, një

formulë magjike e arritshme për të gjithë.

Faza 2. Kur njerëzit filluan të kuptojnë se për të pasur atë jetë, ato objekte, ato buzëqeshjet dhe ata trupa të, një dush pëlqimesh dhe komentesh nuk mjaftonte, diçka filloi të plasarit. Dhe kështu, ndjekësi, nga njëra anë mendonte për postimet e tyre dhe nga ana tjetër jetën e vet të papërsosur, duke pyetur: po unë, ku kam gabuar?

Dhe më pas vazhdonte të "shfletohte", duke shpresuar se postimi tjetër do të përmbante zgjidhjen përfundimtare për të.

Faza 3. Një tjetër vizitë të ekspozuar në rrjetet nga influencersja, në suitën me pamje nga deti që kushton sa gjashtë rroga mujore, dhe admirimi kthehet në zhgënjim me shpejtësinë e dritës.

Duke parë vazhdimisht atë që nuk mund të kemi, ndihemi si spektatorë të pafuqishëm, si të bllokuar në një mëngjes të pafundëm të hënës, pas së dielës së pushimit.

Një nga neologjizmat e shumta që kanë lindur si kërpudha në këtë epokë të mediave sociale është paranoja e krahasimit, ajo ndjenjë zhgënjimi dhe pakënaqësie që jep krahasimi i vazhdueshëm i jetës së tëndë, me ato që shfaqen në rrjetet sociale.

Disa studime kanë eksploruar ndikimin e mediave sociale në uljen e kënaqësisë prej pushimeve në epokën e medi-

ave sociale. Studimi i publikuar në *Frontiers in Psychology* thekson se përdorimi intensiv i Instagramit lidhet me rritjen e ankthit social dhe një perceptim inferioriteti.

Sa më shumë të shfletoni në rrjetet udhëtimet e njerëzve të tjerë, aq më pak do të jeni në gjendje të shijoni udhëtimet tuaja. Të dhënat treguan se njerëzit në fakt priren ta krahasojnë veten me imazhet e përsosura të të tjerëve, shpesh të idealizuara, duke zhvilluar ndjenja të pamjaftueshmërisë dhe zhgënjimit.

Kështu, çdo video e një plazhi tropikal bëhet një grusht në stomak, çdo foto në një restorant me disa yje nuk na bën më të ëndërojmë, përkundrazi na kujton se nuk do ta shijojmë kurrë atë skenë. Edhe nëse i kemi, do të duhet t'i përdorim ato para për pagesën e hipotekës ose për të paguar kopshtin.

Dhe kështu, produkti është një rritje e numrit të ndjekësve, që shfryjnë të gjithë zemërimin dhe frustrimin e tyre, në komente, apo në mesazhe. Dhe që gjithnjë e më shumë, marrin mbrapsht përgjigje: "je ziliqar", apo "je e sëmurë", prej influencersve arrogantë.

Ata nuk janë njerëz të "çmendur që kanë nevojë për trajtim". Në një periudhë historike në të cilën ekonomia po lëkundet dhe e ardhmja duket më e pasigurt

se horoskopi apo parashikimi i motit të kësaj klime të çmendur, të shesësh jetë luksoze, por mbi të gjitha pa kokëçarje duke u dukur, është si të hedhësh kripë mbi një plagë të hapur.

Njerëzit janë lodhur duke u ndjerë të përjashtuar, të lodhur nga të qenit spektatorë të një teatri që përfaqëson vetëm një elitë të vogël. Ndosht në politikë, ndodhi në ekonomi, po ndodh në rrjetet sociale që me 5 miliardë përdoruesit e tyre, janë një përfaqësim i mirë i botës.

Sigurisht, një audiencë që nuk zhvillon mendimin kritik, është më e prirur të ndjekë pa u menduar një influencers, të blejë çdo produkt të sponsorizuar dhe të ndajë e të përforcojë çdo mendim sikur të ishte Ungjill. Kjo jo vetëm që garanton një ndjekje më besnike, por lehtëson mundësitë e fitimit të parave, sepse siç e dimë, delet e bindura janë më fitimprurëse. Prandaj, çdo zërë jashtë korit shuhet menjëherë, etiketohet si humbës dhe futet në indeksin e elitës së mediave sociale dhe një pjese të madhe të ndjekësve besnikë.

Prandaj, është e domosdoshme të "stërvitim" sensin tonë kritik. Të kuptojmë se jetët e përsosura që shohim në mediat sociale nuk janë vetëm të paarritshme si një mirazh në shkretëtirë. Jo, ato as nuk ekzistojnë. Janë një film që na ka pëlqyer dhe kaq. / bota.al



EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT
 PILKINGTON
 Inveri
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



Një ndeshje të shtunën, një të dielën në Superligën e hendbollit

VUSHTRRI, 18 TETOR - Për shkak të angazhimeve evropiane të Rahovecit e Besa Famgasit, në fundjavë zhvillohen vetëm dy ndeshje të xhiros së gjashtë të Superligës së Kosovës në hendboll në konkurrencë të meshkujve. Të shtunën nga ora

20:00 është ndeshja Vushtrria - Kastrioti. Kastrioti është i treti me gjashtë pikë, derisa Vushtrria i ka katër pikë në vendin e katërt. Të dielën është ndeshja Trepça - Prishtina, që fillon në ora 16:00. Prishtina është e pesta me katër pikë, ndërsa Trepça është ende

pa pikë dhe në vendin e fundit. Në fundjavë është edhe xhiroja e katërt në Ligën e Parë në të dy konkurrencat. Te hendbollistët të shtunën janë ndeshjet Vëllaznimi - Drita (19:00) dhe Drenica - Ulpiana (19:30). Takimet e së dielës janë: Prizreni

- Samadrexha (12:30) dhe Deçani - Istogu (16:00). Te hendbollistët, Dukagjini e Jusuf Gërvalla takohen të shtunën nga ora 13:00. Të dielën janë ndeshjet Prizreni - Trepça (14:00), Ulpiana - Llapusha (12:00), CLICK - KEKU (15:30).



Ferizaj mposht Gjilanin, sot derbi Malisheva - Prishtina

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 18 TETOR - Skuadra e Ferizajt ka arritur të premtën një fitore të madhe në përballje me skuadrën e Gjilanit (1-2). Kjo ndeshje u zhvillua në kuadër të javës së nëntë në Superligën e Kosovës në futboll. Në minutën e 14-t Edon Sadriu e ka kaloi skuadrën mysafire në epërsi 0-1, kurse tre minuta para fundit të kësaj pjese, Abdeen Abdul, realizoi për 0-2. Në pjesën e dytë, Senad Jarović ngushtoi epërsinë 1-2 në minutën e 72-të, por kjo ishte krejt çfarë arritën të bënin vendasit. Deri në fundin e takimit, Gjilani mori dy kartonë të kuq, pas përjashtimit me karton të kuq

të Jamal Aragos dhe Besir Ramadanit. Pas kësaj fitore, Ferizaj grumbullon 10 pikë, derisa Gjilani mbetet në kuotën e nëntë pikëve të grumbulluara. Ndërsa sot (e shtunë) është derbi në mes të Malishevës dhe Prishtinës. Kjo ndeshje zhvillohet në stadiumin "Liman Gegaj". Vendasit do të provojnë të fitojnë dhe të vazhdojnë kryesimin në Superligë, në anën tjetër kryeqytetasit pritet ta japin maksimumin që t'i shkaktojnë telashe Malishevës dhe në këtë mënyrë të ngrehen në renditjen tabelore, pasi aktualisht janë në vendin e katërt me katër pikë më pak se skuadra kryesuese, Malisheva, që ka 18 pikë. Të njëjtën ditë zhvillohet edhe



ndeshja në mes të Feronikeli '74 dhe Dritës, me gjilanasit që janë favoritët në këtë ndeshje. "Nikli" ka

vetëm një pikë të grumbulluar dhe zë vendin e fundit në tabelë. Të dielën është derbi i dy skuadrave

nga qyteti i Suharekës, Ballkani - Suharekës. Kampionët në fuqi të Kosovës janë në vend të tretë me 14 pikë, kurse Suhareka e gjashta me 13 pikë. Ndeshje interesante pritet të jetë edhe ajo që zhvillohet në Klinë në mes të Dukagjinit dhe Llapit. Të gjitha ndeshjet zhvillohen nga ora 13:00.

SUPERLIGA / JAVA E NËNTË

Gjilani - Ferizaj 1-2

Të shtunën takohen:
 Malisheva - Prishtina
 Feronikeli '74 - Drita

Të dielën takohen:
 Dukagjini - Llapi
 Ballkani - Suhareka

Sot dy derbi në elitën e basketbollit

MITROVICË, 18 TETOR - ProCredit Superliga vazhdon ndeshjet interesante në fundjavë. Ndeshja e parë e kësaj xhiroje pritet të jetë shumë interesante ndërmjet Trepçës dhe Pejës. Dy skuadrat me traditë në basketbollin e Kosovës synojnë fitoren, në një atmosferë që pritet të jetë e jashtëzakonshme në "Minatori". Mitrovicasit kanë tri fitore dhe dy humbje, ndërsa pejanët dy fitore dhe tri humbje. Sfidë shumë interesante pritet të shtunën në mbrëmje ndërmjet Bashkimit dhe Sigal Prishtinës. Prizrenasit janë e vetmja skuadër pa humbje në elitë, me pesë fitore në pesë ndeshje të zhvilluara, kurse prishtinasit kanë katër fitore dhe një humbje. Takimi pritet të jetë i



barabartë, me të dy skuadrat me traditë që duan fitoren. Takime mjaft të rëndësishme shihen ato që zhvillohen të dielën. Vëllaznimi

ndeshet me Golden Eagle Yllin, ku të dy skuadrat kanë nga dy fitore dhe tri humbje, kurse Proton Cable Prizreni përballlet me Borën, që kanë nga një fitore e katër humbje. Dy takimet janë mjaft të rëndësishme për katër skuadrat, që duan të renditen sa më lart në tabelë.

PROCREDIT SUPERLIGA - JAVA 6

Të shtunën takohen:
 17:00 Trepça - Peja
 19:00 Bashkimi - Sigal Prishtina

Të dielën takohen:
 17:00 Vëllaznimi - Golden E. Ylli
 19:00 Proton Cable Prizreni - Bora

Muharremaj: Suhareka po bëhet me stadium me standarde ndërkombëtare

SUHAREKË, 18 TETOR - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, të enjten bëri me dije se është përzgjedhur koncepti ideor për stadiumin e Suharekës dhe se tashmë ka filluar hartimi i projektit zbatues dhe vitin e ardhshëm do të nisnin procedurat e prokurimit për punimet në këtë impiant sportiv. Një lajm i tillë e ka mirëpritur kryetari i kësaj komune, Bali Muharremaj, i cili në "Facebook" ka shkruar se ky qytet po bëhet me stadium të ri të kategorisë 2, me kapacitet 6518 ulëse, që plotëson standardet më të larta ndërkombëtare. "Ky është lajm i mirë për komunën e Suharekës. Po bëhemi me stadium të ri të kategorisë 2, me kapacitet



6518 ulëse, që plotëson standardet më të larta ndërkombëtare, sipas njoftimit nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Komuna jonë ka bashkëpunuar vazhdimisht, duke dhënë kontribut edhe në ndarjen e parcelës prej 13 hektarëve. Mirëpresim secilin investim që ndodhë në komunën tonë", ka shkruar Muharremaj.

Kosova merr pjesë në Botërorin e Karatesë në Spanjë

PRISHTINË, 18 TETOR - Federata e Karatesë e Kosovës ka njoftuar se Federata Botërore e Karatesë (WKF) ka zyrtarizuar pjesëmarrjen e ekipit të meshkujve të Kosovës në Kampionatin

Botëror të Karatesë për ekipe. "Federata e Karatesë e Kosovës ka kënaqësinë t'ju njoftojë që Federata Botërore e Karatesë (WKF) ka zyrtarizuar pjesëmarrjen e ekipit të meshkujve në

Kampionatin Botëror të Karatesë për ekipe. Përveç ekipit të femrave, i cili tashmë është kualifikuar ndër katër ekipet më të mira në botë, sot kemi pranuar njoftimin zyrtar se ekipi i meshkujve është

përzgjedhur dhe do të marrë pjesë. Federata e Karatesë e Kosovës është jashtëzakonisht krenare dhe entuziaste për këtë lajm dhe për këtë pjesëmarrje historike", thuhet në njoftimin e FKK-së.



Basketbollisti i NBA-s pas dy vjetësh rikthehet në parket

CHICAGO, 18 TETOR - Kur u lëndua më shumë se dy vjet më parë, të gjithë menduan se karriera e tij përfundoi përpara kohe. Por kur kanë kaluar dy vjet, 9 muaj e tre e dy ditë, Lonzo Ball u kthye sërish në parket për Chicago Bulls në sfidën e pragsezonit në NBA kundër Minnesotas. Një

“mrekulli” e vërtetë sportive dhe mjekësore, pasi asnjë atlet tjetër profesionist nuk kishte arritur të kthehej sërish në aktivitet pas një dëmtimi të këtij lloji. Në sezonin e tij të parë me Bulls-in, pas transferimit nga Los Anxheles Lejkërs, pikërisht më 14 janar të vitit 2022, Lonzo Ball theu

gjurin e majtë në një ndeshje të NBA-s, duke këputur edhe ligamentet. Pas testeve mjekësore, prognoza ishte dëshpëruese dhe të gjithë e cilësuan të përfunduar karrierën e tij si profesionist. Por basketbollisti 27-vjeçar nuk u dorëzua. Pas tre operacioneve që rindërtuan gjurin e majtë,

ligamentet e tij dhe një periudhe të gjatë rikuperimi, ai arriti të kthehet sërish në parket. Askush përpara tij nuk e kishte bërë një gjë të tillë pas një dëmtimi të njëjtë në sportin profesionist. Në ndeshjen e parë ai luajti 15 minuta, ndërsa shënoi edhe 10 pikë për Bulls-in. Një histori sportive, por edhe



njerëzore ajo e Lonzo Ball që, gjithashtu, tregon se sa ka përparuar mjekësia sportive.

Kumbulla: Ndihehem i rëndësishëm te Espanyoli

BARCELONË, 18 TETOR - Marash Kumbulla nuk mundi t'i tregonte vlerat e tij te Roma, ndërkohë që edhe fati i keq e ndoqi për shkak të një dëmtimi të rëndë në gju. Në përpjekje për të fituar minuta përpara Evropianit, Kumbulla u transferua te Sassuolo në formë huazimi, por as kjo lëvizje nuk rezultoi e duhura pasi minutat për të ishin me pikatore. Gjatë merkatos së verës Kumbulla u transferua në Spanjë, tek ekipi i Espanyol, një lëvizje e goditur kjo pasi qendërmbrojtësi kuqezi gjeti klubin dhe ambientin e duhur për ta rifituar formën e duhur fizike, mbi të gjitha besimin. Në një intervistë për “Corriere dello Sport”, Kumbulla foli për të shkuar dhe të tashmen e tij. “Ne jemi vetëm në fillim të sezonit. Unë po ndihem mirë dhe po luaj. Po gjej qëndrueshmëri, gjë që është më e rëndësishmja për një sportist. Shpresoj të vazhdoj kështu”, ka thënë Kumbulla. “Espanyol? Më kërkuan... si



trajneri ashtu dhe drejtuesit më bënë të ndihem i rëndësishëm. Askush nuk ju garanton dot një pozicion të përhershëm, por ndjeva se klubi kishte besim tek unë. Dhe ishte e vërtetë. Më ndihmoi shumë fakti që isha gati kur mbërrita këtu, pasi kisha një parasezon veror mjaft të mirë me Romën”, ka shtuar mbrojtësi shqiptar. Kumbulla ka thënë se është i fokusuar tek Espanyoli, në

mënyrë që të përfundojë kampionatin në pozitë sa më të lartë. “E vërteta është se unë nuk po mendoj për këtë. Unë jam këtu dhe dua të kontribuoj për të ndihmuar Espanyolin që të jetë sa më lart në La Liga. Unë gjithashtu po mendoj dhe për Kombëtaren shqiptare. Në fund të sezonit do të shohim se çfarë është më e mira për të bërë”, ka deklaruar Kumbulla.

Sinneri sërish leksion Djokoviqit, Alcarazi fiton derbin ndaj Nadalit

RIYADH, 18 TETOR - Tenisti italian Jannik Sinner dhe ai spanjoll Carlos Alcaraz janë dy finalistët e turneut “Six Kings Slam”, turneu “show” që po zhvillohet në Arabinë Saudite. Një turne ku marrin pjesë gjashtë tenistët më të mirë në botë. Dhe, ashtu sikurse pritej, në finale do të luajnë numrat 1 dhe 2 në botë. Gjithsesi për ta nuk ka qenë aspak e lehtë kualifikimi. Sinner mposhti pas 2 orësh e 30 minutash lojë serbin Novak Djokoviq me rezultatin 2-0 (6-2, 6-7, 6-4). Kjo është fitorja e dytë e italianit ndaj Djokoviq brenda 5 ditësh, gjë që nuk e kishte arritur askush tjetër më parë. Një sfidë me rivalitet dhe emocione, por duket se Sinner tashmë është në një orbitë tjetër. Në gjysmëfinalen tjetër, Alcaraz mundi 2-0 (6-3, 6-3) patriotin e tij Rafael Nadal, që do të tërhiqet nga sporti pas një muaji. Një ndeshje që zgjati një orë e 15 minuta, me



Alcaraz që pati epërsi të madhe në fushë ndaj legjendës Nadal. Ky turne zhvillohet për herë të parë dhe nuk jep pikë në renditjen ATP. Por, e veçanta e tij është se pjesëmarrësit (6 të tillë) kanë marrë nga 1.5 milion dollarë vetëm për pjesëmarrjen. Ndërsa fituesi do të

përfitojë 6 milionë dollarë. Përveç finaleve së madhe mes Sinner dhe Alcaraz, që do të luhet për çmimin e madh, do të zhvillohet edhe “finalja e vogël”, për vendet 3-4 mes Djokoviqit dhe Nadalit. Një mundësi për t'i parë sërish në fushë dy vjet e këtij sporti.

SHKURT

Berisha rinovon kontratën me Leccen

Mesfushori i Kombëtares së Shqipërisë, Medon Berisha, e ka vazhduar bashkëpunimin me skuadrën e Lecces deri në 30 qershor të vitit 2028. Klubi italian beson tek aftësitë e 20-vjeçarit, prandaj ka vendosur ta shpërblejë duke i rinovuar kontratën. “Lecce njofton se ka zgjedhur kontratën me futbollistin Medon Berisha deri më 30 qershor 2028”, thuhet në njoftimin e klubit puliez. Pasi spikati në akademinë e klubit, Berisha ka dy sezone që është pjesë e skuadrës së parë të Lecces. Mesfushori ka luajtur në tri ndeshje këtë sezon në kampionatin italian. Berisha ishte një nga lojtarët që përfaqësoi Shqipërinë në “Euro 2024”, duke u bërë futbollisti më i ri kuqezi që luan në finale të një Kampionati Evropian.

Formula 1 me ndryshime nga botërori i vitit të ardhshëm

Këshilli drejtues i Formulës 1 ka miratuar së fundi, në një mbledhje në Paris, heqjen e pikës shtesë që i jepet pilotit që realizon xhiron më të shpejtë në një garë. Kjo masë do të hyjë në fuqi në botërorin e vitit të ardhshëm. “Këshilli Botëror ka miratuar disa ndryshime të vogla në rregulloret sportive dhe teknike për vitet 2024 dhe 2025, duke përfshirë heqjen e pikës së dhënë për xhiron më të shpejtë”, thuhet në shënimin e disponueshëm në faqen e internetit të FIA-s. Në garën e Singaporit bëri bujë zgjedhja e RB për të ndaluar Daniel Ricciardo për t'i dhënë mundësinë për ta vendosur xhiron më të shpejtë dhe për t'ia hequr Lando Norris pikën shtesë. Duke lejuar kështu Max Verstappen të ketë një avantazh prej 52 pikësh ndaj britanikut. Prandaj, pika që jepet për xhiron më të shpejtë, i prezantuar në vitin 2019, tashmë do t'i përkasë historisë. Heqja e saj nuk është i vetmi ndryshim i miratuar: Nga sezoni i ardhshëm angazhimet e pilotëve fillestarë në sesionin e parë të provave të lira do të dyfishohen.

Barça refuzoi ofertën marramendëse të PSG-së për Yamalin

Presidenti i Barcelonës, Joan Laporta, ka konfirmuar se e kanë refuzuar një ofertë prej 250 milionë eurosh për Lamine Yamal. Paris Saint-Germaini raportohet se ishte i gatshëm ta “thyejë” bankën për Yamalin, duke trokitur në dyert e Barcelonës me një ofertë rekorde prej 250 milionë eurosh para hapjes së afatit kalimtar veror. Drejtuesit e gjigantit francez e kanë parë yllin spanjoll si zëvendësuesin adekuat të Kylian Mbappes, i cili gjatë verës u transferua te Real Madridi. Sidoqoftë, Laporta ishte i sigurt për potencialin e Yamalit, duke refuzuar këtë ofertë dhe duke i ofruar atij mbështetje për të krijuar më shumë histori në “Camp Nou”. “Ata erdhën për të blerë Lamine Yamal nga unë për 250 milionë euro dhe unë u thashë ‘jo’. Ai është lojtari më i famshëm në botë. Cila është vlera e vërtetë e Lamine? Kjo nuk reflekton në librin e rekordeve”, ka thënë Laporta.

Lukaku: Conte është i veçantë, di të vendosë raporte me lojtarët

“Gjëja më e veçantë të Conte është raporti mjaft i ngushtë që ai krijon me lojtarët e tij, mënyra se si ai komunikon me skuadrën. Njësoj si Guardiola, Mourinho, apo Ancelotti, janë trajnerë të mëdhenj”, këto janë

fjalët e Romelu Lukakut. Sulmuesi belg njihet tashmë për raportin shumë të ngushtë që ka me trajnerin e tij Antonio Conte. Ai ishte njeriu i duhur, i cili e kërkoi me ngulm ardhjen e Lukakut te Napoli, me një

raport të fortë, që nisi që prej kohës kur të dy ishin pjesë e Interit. Në një intervistë të lëshuar për “Amici dello Sport”, belgu foli edhe për nisjen e raportit mes tij dhe Contes tek Interi si dhe fjalët e para të

trajnerit ndaj tij: “Mbah mend që Conte më tha: ‘Romelu në sistemin e lojës time, t'i nuk mund ta mbash më topin aq gjatë, por duhet ta kthesh mbrapa menjëherë të shokët e skuadrës, siç bën Lautaro’.

Conte është i veçantë, pikërisht për urat e komunikimit që vendos me lojtarët. Ai po bën të njëjtën gjë edhe te Napoli, me lojtarë si Kvaratskhelia apo McTominay. Ai është i aftë së bëri diçka të tillë”.

Kompania Rajonale e Mbeturinave
Regjionale Komitimi dhe Organizimi Opasë
"PASTRIMI" sh.a. s.d.
Nr. 6123 dt. 18-10-2024
Prishtinë - Prishtinë



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "PASTRIMI" SH.A

Duke u bazuar në Ligjin Nr. Ligjin Nr. 03/L-212 i Punës konkretisht Neni 8 Udhëzimin Administrativ MFPT Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik konkretisht Neni 5 Paragrafi 1,2 dhe Neni 7, Rregulloren Nr. 01/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në KRM "Pastrimi" SH.A, Vendimin e datës 17.10.2024 me numër të protokollit 6072 të Kryeshefit Ekzekutiv të KRM "Pastrimi" SH.A, shpallë këtë:

KONKURS PUBLIK (Për plotësimin e vendit të punës)

Titulli i vendit të Punës: "Asistent Administrativ në Njësine Operative në Prishtinë" në KRM "Pastrimi" SH.A (1) pozitë,

Departamenti: Njësia Operative Prishtinë

Numri i Referencës: NJO/PR-19/2024

Koeficienti/Paga mujore: Niveli XIV

Kohëzgjatja e Kontratës së Punës: Me kohë të pa caktuar,

Periudha Provuese: 3 muaj

1. Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Ndhmon Menaxherin në punët e tyre të përditshme;
- Përpilon shkresa të cilat kërkohen nga Menaxheri
- Asiston në çështjet teknike të zyrës;
- Pranon palët dhe vizitorët që i adresohen Menaxherit dhe mbanë shënime për takimet e Menaxherit brenda dhe jashtë kompanisë;
- Ruan dhe sistemon dokumentet sipas kërkesave të Menaxherit
- Pranon dokumentet e punëtorëve nga Menaxheri drejtuar Burimeve Njerëzore dhe njëherit shërben urë lidhëse ndërmjet tyre;
- Është përgjegjës për pranimin e palëve të Menaxherit, përkatësisht caktimit të terminëve për palët e treta;
- Mbanë evidencën e takimeve dhe procesverbalet e takimeve të Menaxherit ashtu siç kërkohet;
- Mirëmban marrëdhëniet me klientin dhe palët e treta;
- Kryen punë dhe detyra tjera që lidhen me përshkrimin e detyrave të punës, të ngarkuara nga Menaxheri;
- Për punën e tij i përgjigjet Menaxherit të Njesis.

2. Kriteret e përgjithshme për pranim në detyrë:

- ✓ Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,
- ✓ Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- ✓ Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- ✓ Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- ✓ Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale;
- ✓ Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën
- ✓ Të kalojë me sukses procedurat e pranimin të përcaktuara në këtë ligj.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- ✓ **Arsimimi i kërkuar:** Shkollim i mesëm
- ✓ **Përvoja e punës e kërkuar:** 1 vite përvojë pune

4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

- ✓ Aftësi të arsytimit logjik dhe analizës;
- ✓ Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.
- ✓ Shkathtësi hulumtuuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- ✓ Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- ✓ Njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;

5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

- ✓ Aplikacioni i plotësuar dhe nënshkruar nga kandidati,
- ✓ Kopje të diplomave të dhëna nga Institucionet Arsimore,
- ✓ Kopje të dëshmisë së punësimit (Trusti Pensional, Vërtetimi, apo Kontratë të Punës),
- ✓ Kopje të dëshmisë së trajnimeve dhe kurseve,
- ✓ Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit, (E dëshirueshme).
- ✓ Kopje të Letërnjoftimit,

- ✓ Vërtetimin që nuk është i dënuar për kryerjen e një veprës penale jo më të vjetër se 3 muaj.

6. Mënyra e aplikimit në konkurs:

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në Zyret e Burimeve Njerëzore në KRM "Pastrimi" SH.A.
Të gjitha aplikimet duhet të bëhet vetëm në mënyrë elektronike nëpërmjet platformës elektronike; punesimi.krmpastrimi@gmail.com

7. Data dhe ora e saktë e përmbvilljes së Konkursit Publik;

Konkursi Publik zgjatë 15 ditë nga data 19.10.2024 deri me datën 04.11.2024. Koha e fundit e pranimit të aplikimeve është ora 16:00.

Të gjitha aplikimet që arrijnë pas afatit të fundit nuk do të merren parasysh.

8. Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit.

Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të CV-së, testit shkrim dhe me intervistim (testi me gojë).

- ✓ CV-ja e kandidatit vlerësohet deri në dhjetë (10) pikë,
- ✓ Testi me shkrim vlerësohet deri në shtatëdhjetë (70) pikë,
- ✓ Intervista (testi me goje) vlerësohet deri në njëzetë (20) pikë.

Procedura e vlerësimit përmban gjithsejtë njëqind (100) pikë, ku kalueshmëria është arritja e së paku pesëdhjetë e pesë (55) pikëve nga të gjitha fazat e Konkursit Publik.

9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.

Të gjithë kandidatët do të njoftohen nëpërmjet komunikimit elektronik dhe individualisht.

10. Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

Konkursi Publik i hapur deri me datën 04.11.2024.

Faza e verifikimit paraprak të aplikacioneve deri 7 ditë,

Faza e testit me shkrim deri 10 ditë pas fazës së verifikimit,

Faza e Intervistës deri 7 ditë pas shpalljes së rezultateve të testit me shkrim.

Publikimi i rezultateve deri 5 ditë pas vlerësimit të intervistë.

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Almir Saliji shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën Q.K. "11 Marsi " Prizren.

- Hava Beladhari shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën sh.m.e. " Ymer Prizreni" Prizren.

- Jahir Krasniqi shpall të pavlefshme certifikatën Q.K "11 Marsi" Prizren.

- Arjeta Vokshi shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën sh.m.e. " Ymer Prizreni " Prizren.

- Mentor Nuredini shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Arjeta Vokshi shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën sh.m.e. " Ymer Prizreni" Prizren.

- Bujar Morina nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4 dhe diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Gjlymsere Cena nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.e. "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

Kompania Rëndësore e Mbeturinisve
Regjistruarë në Komisionin e Udhëzimit Qendror
"PASTRIMI" sh.p.ë.d.
Nr. 6123 dt. 18-10-2024
Prishtinë - Prishtinë



REGIONALNO PREDUZEÇE ZA OTPAD "PASTRIMI" SH. A

Na osnovu Zakona br. 03/L-212 o radu, člana 8. Administrativne instrukcije FPT br. 01/2024 o uređenju konkursnih postupaka u javnom sektoru, posebno člana 5. stav 1,2 i člana 7. Uredbe br. 01/2024 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta u RM "Pastrimi" SH. A, Odluka od 17.10.2024. godine sa brojem protokola 6072 glavnog izvršnog direktora RM "Pastrimi" SH. A onda, proglasite ga:

JAVNI KONKURS (Za završetak radnog mesta)

Naziv radnog mesta: "Administrativni asistent u Operativnoj jedinici u Prištini" u KRM-u "Pastrimi" SH. (1) pozicija,

Odeljenje: Operativna jedinica Priština

Referentni broj: NJO/PR-19/2024

Mesečni koeficijent / plata: nivo XIV

Trajanje ugovora: Bez fiksnog vremena,

Probni period: 3 meseca

1. Dužnosti i odgovornosti:

- Pomozite menadžeru u svakodnevnom poslu.
- Napišite pisma koja traži menadžer.
- Pomoć u tehničkim pitanjima kancelarije;
- Prihvata stranke i posetioce koji se obraćaju Menadžeru i vodi evidenciju o sastancima menadžera unutar i izvan Društva;
- Čuvajte i organizujte dokumente u skladu sa zahtevima menadžera
- Prihvata dokumente zaposlenih od menadžera do ljudskih resursa i služi most između njih;
- Odgovoran je za prihvatanje stranaka Menadžeru, odnosno dodeljivanje imenovanja trećim licima;
- Vodite evidenciju o sastancima i zapisnike sa sastanaka menadžera na zahtev;
- Održava odnose sa klijentima i trećim stranama;
- obavlja radne i druge poslove u vezi sa opisom radnih zadataka koje dodeljuje rukovodilac;
- On je odgovoran menadžeru jedinice.

2. Opšti kriterijumi za prijem na dužnost:

- ✓ da bude državljanin Republike Kosovo,
- ✓ Da imaju punu sposobnost da deluju, u skladu sa važećim zakonima;
- ✓ da poseduje najmanje jedan od službenih jezika, u skladu sa Zakonom o jezicima;
- ✓ Biti u stanju da izvrši odgovarajući zadatak;
- ✓ Da ne bude osuđen za izvršenje krivičnog dela;
- ✓ Imaju obrazovanje, profesionalno radno iskustvo i / ili veštine potrebne za poziciju
- ✓ Uspešno proći procedure prijema utvrđene u ovom zakonu.

3. Opšti formalni zahtevi

- ✓ **Potrebno obrazovanje:** Srednje obrazovanje
- ✓ **Potrebno radno iskustvo:** 1 godina radnog iskustva

4. Znanje, veštine i kvalitete potrebne u postupku zapošljavanja

- ✓ Sposobnost logičkog zaključivanja i analize;
- ✓ Komunikacijske veštine i lični uticaj, uključujući sposobnost predstavljanja.
- ✓ istraživanje, analitika, evaluacija i formulisanje preporuka i stručnih saveta;
- ✓ sposobnost donošenja nezavisnih stručnih presuda i ostvarivanja diskrecionog prava o pitanjima i davanja značajnog doprinosa razvoju i sprovođenju politike;
- ✓ Opsežno poznavanje oblasti, istraživačkih metoda, koje pomažu u pripremi osnovnih ili analitičkih izveštaja;

5. Dokumenti koji se podnose u okviru prijave i način njihovog podnošenja

- ✓ Prijava popunjena i potpisana od strane kandidata,
- ✓ Kopija diploma koje su izdale obrazovne institucije,
- ✓ Kopija potvrde o zaposlenju (penzioni fond, potvrda ili ugovor o radu),
- ✓ Dokazi o obukama i kursovima,
- ✓ Kopija procene rada za poslednje dve godine, (poželjno).
- ✓ Kopije lične karte,
- ✓ Dokaz da nije osuđen za krivično delo ne starije od 3 meseca.

6. Način prijavljivanja na konkurs:

Zainteresovani kandidati, zvanični obrazac se može dobiti u kancelarijama za ljudske resurse u RM "Pastrimi" SH.A.

Sve prijave moraju biti podnete elektronskim putem samo putem elektronske platforme; punesimi.krmpastrimi@gmail.com

7. tačan datum i vreme završetka javnog konkursa:

Javni konkurs traje 15 dana od 19.10.2024. do 04.11.2024. godine. Poslednji put prijema aplikacija je 4 posle podne.

Sve prijave koje stignu nakon isteka roka neće se razmatrati.

8. Način vrednovanja i kriterijumi vrednovanja.

Evaluacija kandidata vrši se na osnovu CV-a, pismenog i intervjuškog testa (usmeni test).

- ✓ CV kandidata je ocenjen do deset (10) bodova,
- ✓ Pismeni test se vrednuje do sedamdeset (70) bodova,
- ✓ Intervju (usmeni test) se procenjuje na dvadeset (20) bodova.

Postupak vrednovanja sadrži ukupno sto (100) bodova, pri čemu je prolaz ostvaren najmanje pedeset pet (55) bodova iz svih faza Javnog konkursa.

9. Način obaveštavanja i komunikacije sa kandidatima.

Svi kandidati će biti obavešteni putem elektronske komunikacije i pojedinačno.

10. Približan raspored postupka zapošljavanja:

Javni konkurs otvoren do 04.11.2024.

Preliminarna faza verifikacije prijave do 7 dana,

Faza pismenog testiranja do 10 dana nakon faze verifikacije,

Faza intervjuja do 7 dana nakon objavljivanja rezultata pismenog testa.

Objavljivanje rezultata do 5 dana nakon evaluacije intervjuja.

Napomena: Nesastavljeni, neskenirani dokumenti i oni koji stignu nakon isteka roka za konkurs neće biti pregledani.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Kompania Rajonale e Mbeturinave
Rajonale e Konkursit në Organizatën Qendrore
PASTRIMI s.p.a. s.d.d.
Nr. br. 6124 dt. 18.10.2024
Prishtinë - Prishtinë



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE " PASTRIMI" SH.A

Duke u bazuar në Ligjin Nr. Ligjin Nr. 03/L-212 i Punës konkretisht Neni 8 Udhëzimin Administrativ MFPT Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik konkretisht Neni 5 Paragrafi 1,2 dhe Neni 7, Rregulloren Nr. 01/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në KRM "Pastrimi" SH.A, Vendimin e datës 17.10.2024 me numër të protokollit 6073 të Kryeshefit Ekzekutiv të KRM "Pastrimi" SH.A, shpallë këtë:

KONKURS PUBLIK (Për plotësimin e vendit të punës)

Titulli i vendit të Punës: "Zyrtar Menaxhues të Rrjeteve Sociale" në KRM "Pastrimi" SH.A (1) pozitë,

Departamenti: Kabineti i Kryeshefit

Numri i Referencës: KKE/KJ-18/2024

Koeficienti/Paga mujore: Niveli XI

Kohëzgjatja e Kontratës së Punës: Me kohë të pa caktuar,

Periudha Provuese: 3 muaj

1. Detvat dhe Përgjegjësitë:

- Menaxhimi dhe mbikëqyrja e rrjeteve sociale dhe përmbajtjes së Web-it;
- Monitorimi dhe moderimi i komenteve në Rrjetet sociale dhe Web;
- Zhvillimi, implementimi dhe menaxhimi i strategjisë së kompanisë në Rrjetet sociale;
- Përcaktimi i treguesve kryesorë të performancës, vendosjen e objektivave dhe rritjen e performancës;
- Mirëmbajtjen e identitetit të brendit përmes komunikimeve në Rrjetet sociale dhe në Web;
- Matjet dhe raportimi periodik tek menaxhmenti rreth arritjeve në Rrjetet sociale dhe Web;
- Përditësimin e praktikave dhe teknologjive më të mira të Rrjeteve sociale;
- Kryen edhe punë të tjera sipas kërkesës së Udhëheqësit dhe KE;
- Për punën e tij i përgjigjet Udhëheqësi i Njësisë për komunikim Publik dhe Marketing

2. Kriteret e përgjithshme për praninë në detyrë:

- ✓ Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,
- ✓ Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- ✓ Të zotërojë të paktën njëri nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- ✓ Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- ✓ Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale;
- ✓ Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën
- ✓ Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- ✓ **Arsimimi i kërkuar:** Diplome Universitare ose shkollim i mesëm
- ✓ **Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku 2 vite përvojë pune profesionale

4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

- ✓ Aftësi të arsytimit logjik dhe analizës;
- ✓ Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.
- ✓ Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- ✓ Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- ✓ Njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;

5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

- ✓ Aplikacioni i plotësuar dhe nënshkruar nga kandidati,
- ✓ Kopje të diplomave të dhëna nga Institucionet Arsimore,
- ✓ Kopje të dëshmisë së punësimit (Trusti Pensional, Vërtetimi, apo Kontratë të Punës),
- ✓ Kopje të dëshmisë së trajnimeve dhe kurseve,
- ✓ Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit, (E dëshirueshme).
- ✓ Kopje të Letërnjoftimit,
- ✓ Vërtetimin që nuk është i dënuar për kryerjen e një veprës penale jo më të vjetër se 3 muaj.

6. Mënyra e aplikimit në konkurs:

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në Zyret e Burimeve Njerëzore në KRM " Pastrimi" SH.A.

Të gjitha aplikimet duhet të bëhet vetëm në mënyrë elektronike nëpërmjet platformës elektronike; punesimi.krmpastrimi@gmail.com

7. Data dhe ora e saktë e përmbylljes së Konkursit Publik:

Konkursi Publik zgjatë 15 ditë nga data 19.10.2024 deri me datën 04.11.2024. Koha e fundit e pranimit të aplikimeve është ora 16:00.

Të gjitha aplikimet që arrijnë pas afatit të fundit nuk do të merren parasysh.

8. Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit.

Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të CV-së, testit shkrim dhe me intervistim (testi me gojë).

- ✓ CV-ja e kandidatit vlerësohet deri në dhjetë (10) pikë,
- ✓ Testi me shkrim vlerësohet deri në shtatëdhjetë (70) pikë,
- ✓ Intervista (testi me gojë) vlerësohet deri në njëzetë (20) pikë.

Procedura e vlerësimit përmban gjithsejtë njëqind (100) pikë, ku kalueshmëria është arritja e së paku pesëdhjetë e pesë (55) pikëve nga të gjitha fazat e Konkursit Publik.

9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.

Të gjithë kandidatët do të njoftohen nëpërmjet komunikimit elektronik dhe individualisht.

10. Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

Konkursi Publik i hapur deri me datën 04.11.2024.

Faza e verifikimit paraprak të aplikacioneve deri 7 ditë,

Faza e testit me shkrim deri 10 ditë pas fazës së verifikimit,

Faza e Intervistës deri 7 ditë pas shpalljes së rezultateve të testit me shkrim.

Publikimi i rezultateve deri 5 ditë pas vlerësimit të intervistë.

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Llullat, Rr. Bajram Kelmendi

Kompania Rejionale e Mbeturisë
Rajonale e Mbeturisë të Qytetit të Prishtinës
"PASTRIMI" sh.a. ud.
Nr. 6124 dt. 18.10.2024
Prishtinë - Prishtinë



REGIONALNO PREDUZEĆE ZA OTPAD "PASTRIMI" SH. A

Na osnovu Zakona br. 03/L-212 o radu, člana 8. Administrativne instrukcije FPT br. 01/2024 o uređenju konkursnih postupaka u javnom sektoru, posebno člana 5. stav 1,2 i člana 7. Uredbe br. 01/2024 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta u RM "Pastrimi" SH. A, Odluka od 17.10.2024. godine sa brojem protokola 6073 glavnog izvršnog direktora RM "Pastrimi" SH. A onda, proglasite ga:

JAVNI KONKURS (Za završetak radnog mesta)

Naziv posla: "Službenik za upravljanje društvenim mrežama" u RM "Pastrimi" SH. (1) pozicija,

Odeljenje: Glavni kabinet

Referentni broj: KKE / KJ-18 / 2024

Koeficijent / Mesečna plata: Nivo XI

Trajanje ugovora: Bez fiksnog vremena,

Probni period: 3 meseca

1. Dužnosti i odgovornosti:

- Upravljanje i nadzor društvenih mreža i veb sadržaja;
- Praćenje i moderiranje komentara na društvenim mrežama i vebu;
- Razviti, implementirati i upravljati strategijom kompanije u društvenim mrežama;
- Određivanje ključnih pokazatelja učinka, postavljanje ciljeva i povećanje performansi;
- Održavajte identitet brenda kroz komunikaciju na društvenim mrežama i na Vebu;
- Merenja i periodično izveštavanje menadžmenta o dostignućima na društvenim mrežama i vebu;
- Ažuriranje najboljih praksi i tehnologija društvenih mreža;
- obavlja i druge zadatke na zahtev lidera i EK;
- Šef Jedinice za javnu komunikaciju i marketing odgovara za svoj rad.

2. Opšti kriterijumi za prijem na dužnost:

- ✓ da bude državljanin Republike Kosovo,
- ✓ Da imaju punu sposobnost da deluju, u skladu sa važećim zakonima;
- ✓ da poseduje najmanje jedan od službenih jezika, u skladu sa Zakonom o jezicima;
- ✓ Biti u stanju da izvrši odgovarajući zadatak;
- ✓ Da ne bude osuđen za izvršenje krivičnog dela;
- ✓ Imaju obrazovanje, profesionalno radno iskustvo i / ili veštine potrebne za poziciju
- ✓ Uspešno proći procedure prijema utvrđene u ovom zakonu.

3. Opšti formalni zahtevi

- ✓ **Potrebno obrazovanje:** Visoka stručna sprema ili srednja škola
- ✓ **Potrebno radno iskustvo:** Najmanje 2 godine profesionalnog iskustva

4. Znanje, veštine i kvalitete potrebne u postupku zapošljavanja

- ✓ Sposobnost logičkog zaključivanja i analize;
- ✓ Komunikacijske veštine i lični uticaj, uključujući sposobnost predstavljanja.
- ✓ istraživanje, analitika, evaluacija i formulisanje preporuka i stručnih saveta;
- ✓ sposobnost donošenja nezavisnih stručnih presuda i ostvarivanja diskrecionog prava o pitanjima i davanja značajnog doprinosa razvoju i sprovođenju politike;
- ✓ Opsežno poznavanje oblasti, istraživačkih metoda, koje pomažu u pripremi osnovnih ili analitičkih izveštaja;

5. Dokumenti koji se podnose u okviru prijave i način njihovog podnošenja

- ✓ Prijava popunjena i potpisana od strane kandidata,
- ✓ Kopija diploma koje su izdale obrazovne institucije,
- ✓ Kopija potvrde o zaposlenju (penzioni fond, potvrda ili ugovor o radu),
- ✓ Dokazi o obukama i kursevima,
- ✓ Kopija procene rada za poslednje dve godine, (poželjno).
- ✓ Kopije lične karte,
- ✓ Dokaz da nije osuđen za krivično delo ne starije od 3 meseca.

6. Način prijavljivanja na konkurs:

Zainteresovani kandidati, zvanični obrazac se može dobiti u kancelarijama za ljudske resurse u RM "Pastrimi" SH.A.

Sve prijave moraju biti podnete elektronskim putem samo putem elektronske platforme:

punesimi.krmpastrimi@gmail.com

7. tačan datum i vreme završetka javnog konkursa:

Javni konkurs traje 15 dana od 19.10.2024. do 04.11.2024. godine. Poslednji put prijema aplikacija je 4 posle podne.

Sve prijave koje stignu nakon isteka roka neće se razmatrati.

8. Način vrednovanja i kriterijumi vrednovanja.

Evaluacija kandidata vrši se na osnovu CV-a, pismenog i intervjuškog testa (usmeni test).

- ✓ CV kandidata je ocenjen do deset (10) bodova,
- ✓ Pismeni test se vrednuje do sedamdeset (70) bodova,
- ✓ Intervju (usmeni test) se procenjuje na dvadeset (20) bodova.

Postupak vrednovanja sadrži ukupno sto (100) bodova, pri čemu je prolaz ostvaren najmanje pedeset pet (55) bodova iz svih faza Javnog konkursa.

9. Način obaveštavanja i komunikacije sa kandidatima.

Svi kandidati će biti obavešteni putem elektronske komunikacije i pojedinačno.

10. Približan raspored postupka zapošljavanja:

Javni konkurs otvoren do 04.11.2024.

Preliminarna faza verifikacije prijave do 7 dana,

Faza pismenog testiranja do 10 dana nakon faze verifikacije,

Faza intervjuja do 7 dana nakon objavljivanja rezultata pismenog testa.

Objavljivanje rezultata do 5 dana nakon evaluacije intervjuja.

Napomena: Nesastavljeni, neskenirani dokumenti i oni koji stignu nakon isteka roka za konkurs neće biti pregledani.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulo C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

